



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**NGA DËGJIMI PUBLIK I KOMISIONIT PËR MBIKËQYRJEN
E FINANCAVE PUBLIKE, TË MBAJTUR MË 22.01. 2014**

**JANAR
2014**

Mbledhjen e kryeson kryetari i Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike, zoti Ali Sadriu

KRYETARI: Nëse jeni të mendimit do të kishim filluar.

Fillimisht do të doja të përshëndes auditorin e përgjithshëm dhe zëvendësin e tij me staf dhe të përshëndes përfaqësuesit e Ministrisë së Financave, mediat dhe të gjithë të pranishmit.

Sot kem parapa vetëm një pikë të rendit të ditës dhe ajo është një debat rreth Projektligjit për Zyrën e Auditorit të Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare gjegjësisht Zyrën e Auditorit të Përgjithshëm do të thotë dy raporte auditorin edhe Zyrën e Auditorit.

Komisioni këtë material e ka shqyrtua dhe në harmoni me dispozitat ligjore të Ligjit numër 236 ka formua një grup punues të cilit i ka dhënë autorizime që ai ta shqyrtoj, studioj të amendamentej dhe njëkohësisht ta njoftoj në vazhdimësi Komisionin për Mbikëqyrje të Financave Publike.

Ky debat, ky dëgjim publik sot që është organizua është pjesë e kësaj kompanie dhe për më gjerësisht ku kanë mëri, cilat janë sfidat, cilat janë përballjet e grupit punues do të na prezanton kryetari i grupit punues që njëherit është edhe nënkryetar i parë i Komisionit, zoti Ramiz Ladrovici. Ramiz e ke fjalën.

RAMIZ LADROVCI: Faleminderit, kryetar!

E përshëndes zëvendësministrin e Financave, zoti Fetahu edhe stafin e tij,
Përshëndes zotin Olofsson dhe Artanin me staf,
Përshëndes edhe Sindikatën e Pavarur të Zyrës së Auditorit,
Përshëndes Përfaqësuesit e OSBE-së,

Në radhë të parë duhet të bëjë një hyrje lidhur me rregullat për rrjedhën e këtij dëgjimi publik.

Grupi Punues për shqyrtimin e Projektligjit për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit është në proces të shqyrtimit të amendamentimit të këtij projektligji.

Duke pasur parasysh rëndësinë e këtij projektligji Grupi Punues ka rekomanduar që të mbahet dëgjim publik me të gjithë të interesuarit dhe ata të cilët mund të japin kontributin e tyre gjatë amendamentimit të këtij projektligji.

Të gjitha propozimet të cilat dalin nga ky dëgjim publik, Grupi Punues do t'i shqyrtoj me kujdes dhe do të vendos lidhur me to.

Ju njoftoj se të drejtë për të marrë fjalën në këtë dëgjim publik kanë të ftuarit me të cilët ka kohë kam njoftuar që do të marrin pjesë në këtë dëgjim publik.

Kohëzgjatja e diskutimit për të ftuarit është pesë minuta, ndoshta dikush kur ka edhe më shumë ne do të japim atë mundësi.

Anëtarët e Komisionit mbajnë të drejtën për të shtruar pyetje ose për të bërë komentet e tyre gjatë këtij dëgjimi.

Propozimet do të dorëzohen me shkrim ose edhe në formë elektronike do të ishte më mirë për ne dhe një kopje në Njësine për Mbështetjen e këtij Komisioni, kopy add.

Ndërsa sa i përket projektligjit, ai përbëhet prej 32 neneve dhe në përgjithësi ka renditje të mirë të paragrafëve dhe nën-paragrafëve.

Të gjitha nenet janë të titulluar që është praktikë e mirë e hartimit të legjislacionit.

Ky projektligj rregullon organizimin, veprimtarinë dhe kompetencat e auditorit të përgjithshëm dhe Zyrës Kombëtare të Republikës së Kosovës si dhe përcakton fushëveprimin për auditimin e jashtëm të fondeve publike, ekzekutimin e buxhetit, përdorimin dhe qeverisjen e burimeve publike.

Sipas vlerësimit të ndikimit buxhetor të Ministrisë së Financave, projektligji ka implikime buxhetore dhe mund të krijoj të hyra.

Me Projektligjin për buxhetin për vitin 2014 dhe me KESH 2014-2016 nuk ishte planifikuar buxhet dhe të hyra shtesë.

Lidhur me këtë Komisioni i ka rekomanduar Komisionit për Buxhet dhe Financa të parashihet me buxhetin e ZAP-it edhe kjo shumë për implementimin e këtij ligji.

Ndërsa sipas deklaratës për pajtueshmërinë me legjislacionin e BE-së Projektligji nuk i cenon parimet themelore të legjislacionit të BE-së.

Në parim me rekomandimin e Komisionit, Kuvendi ka miratuar këtë projektligj por që i njëjti ka edhe mangësi të cilat pritet të evitohen gjatë procedurës së amendamentimit duke i marrë për bazë të gjitha propozimet që i adreson Kuvendi.

Unë e hapë diskutimin edhe fjalën, kryetar, mund të kenë në radhë të parë anëtarët e Komisionit.

Atëherë, Kush e donë fjalën? Urdhëro kryetar, a doni të diskutoni?

KRYETARI ALI SADRIU: Veç për një çështje, dhe më fal Valbona! Me që është debat për këtë projektligj, ne e kemi shqyrtuar si anëtarë të Komisionit dhe një grup i madh e kemi shqyrtuar dhe i kemi opinionet tona.

Do të kisha pasur dëshirë që më shumë të kem refleksione nga ata të cilët e kanë kontaktin e parë me këtë projektligj apo edhe ata të cilët kanë pasur dhe ndërkohë kanë edhe informacione shtesë, në kuptimin që ta racionalizojmë kohën për të marrë atë çka pretendohen të marrë.

Pra urdhëroni anëtarët e Komisionit nëse keni dikush diçka. Po shoh, Valbona e ngriti dorën. Urdhëro Valbona!

VALBONA DIBRA: Faleminderit, kryetar!
I nderuar zëvendësministër dhe stafi mbështetës,
I nderuar zoti Olofsson,
Të nderuar kolegë deputetë,
Të nderuar të pranishëm,

Para se të diskutoj për Ligjin i cili është i një rëndësie të veçantë, unë dua të informoj zoti kryetar me siguri jeni edhe ju në dijeni por nuk e dijë arsyen pse nuk është diskutuar ose pse nuk është reaguar në emër të Komisionit për dokumentin të cilin e kemi marrë nga eksperti të cilin e keni angazhuar ose e kemi angazhuar ne si Komision ditët e fundit.

Eksperti i SIGMA-s të cilin e ka ofruar për Komisionin një vlerësim për ligjin të cilin vlerësim unë e vlerësoj jashtëzakonisht. Mirëpo dokumentin të cilin nga ka adresua eksperti përmban fusnotën, përmban fusnotë, dokumenti të cilin na ka dërgua SIGMA është me fusnotë. Është me fusnotë!

Unë nuk e dijë arsyen pse, sepse dihet që marrëveshja u nënshkrua në Bruksel edhe është arrit marrëveshja që Kosova të përfaqësohet vetëm në nisma rajonale dhe në

forume ndërkombëtare e jo në Republikën e Kosovës sepse çdo dokument që vjen në institucionet e Republikës së Kosovës është i obliguar me Kushtetutë të përmbajë logon e republikës së Kosovës.

Kjo çështje ndoshta duket teknike, ndoshta u bë edhe pa qëllim por kisha kërkuar si Komision të reagojmë sepse nuk dëshiroj të pranojmë një dokument të tillë që është jashtëligjor.

Ndërsa sa i përket ligjit, ne edhe si grup punues kur kemi vendos në vitin 2013 dhe kemi pa të arsyeshme që ligji është e nevojshme të amendamentohet dhe më vjen shumë mirë pas edhe insistimit tim që të futet në legjislacionin e vitit aktual. Ligji na ka ardhur nga Qeveria dhe unë e përshëndes edhe punën e Qeverisë në bashkëpunim me akterë të tjerë.

Unë vërejtjet e mia i kam dhënë në seancën plenare në leximin e parë kur është bërë dhe këto vërejtje do t'i paraqes sot nëse është nevoja, por shoh të arsyeshme më shumë të marrim mendime nga akterët tjerë të jashtëm të cilët sot i kemi këtu. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit edhe juve! Zoti Lage, e pash një interesim të juajin. Urdhëro!

LAGE OLOFSSON: (Marrë nga përkthimi simuluan) Faleminderit, kryetar! Kam punuar për SIGMA-në për tetë vjet, kështu që në të gjitha komunikimet që SIGMA i ka bërë me Kosovën ato janë të obliguar nga Komisioni Evropian që të përdorin fusnotën.

(Përkthyesi simultan: A jeni duke më dëgjuar? Nuk e di çka është problemi)

(Ndërprerje e shkurtër e incizimit)

Faleminderit kryetar! Për sa i përket fusnotën, SIGMA është e obliguar nga Bashkim Evropian që të përdori fusnotën në komunikimin e saj me Kosovën. Kjo është pjesë e marrëveshjes me Kosovën dhe nuk kanë ndonjë ndryshim, ata gjithmonë e kanë bërë këtë, e kanë në vlerësimet e tyre në çdo gjë. Kjo është vetëm një informatë për Valbonën.

Pra, ky është fakti dhe mund ta shihni në çfarëdo lloj komunikimi që ata kanë me këtë vend, por tani nuk do të komentoj ndonjë gjë për nenet dhe për ligjin. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Vazhdojmë me diskutim.

Ju lutem, ju lutem Valbone a je e interesuar me diskutuar, atëherë lype fjalën. Në fund e le a , mirë pra urdhëro!

VALBONA DIBRA: Ju faleminderit kryetar!

Zoti Lage, unë e kam marrëveshjen, e kem lexuar dhe se i kam 34 ose më shumë organizata ndërkombëtare të cilat përdorin fusnote dhe SIGMA nuk është e përfshirë në to, në këto organizata të cilat mundesh me i pa dhe ne si Komision e kemi angazhuar ekspertin e jo SIGMA-n si kompani më sa e di unë.

KRYETARI: Paraprakisht një sqarim ta bëjë.

Komisioni ka kërkuar nga SIGMA, që SIGMA t'ia sigurojë një ekspert dhe në harmoni me te, SIGMA na e ka qua ekspertin i cili ka trajtuar projektligjin, ka bërë komente të vlefshme.

Sa i përket fusnotës, unë mendoj që Lage e dha sqarimin e vet. Nëse ka dikush koment tjetër nga institucionet e Kuvendit, gjegjësisht Zyra juridike, a do të duhet në këtë rast, ky është një këshillë, një material që e ndihmon Komisionin që të nxjerr një projektligj, gjegjësisht një ligj sa më adekuat për funksionimin e këtyre dy institucioneve, pra Auditorit të Përgjithshëm dhe Zyrës së Auditorit të Kosovës.

Mendoj që në këtë moment ky është një akt për nevojat e Komisionit dhe nuk kisha dashur të humbim shumë kohë rreth kësaj çështjeje, por të kalojmë në temë drejtpërdrejtë në vërejtjet, sugjerimet, amendamentimet që do t'ia bëjmë këtij projektligji. Unë e bëra për hyrje. Urdhëro zotëri kryetar i grupit udhëheq mbledhjen dhe të vazhdojmë.

RAMIZ LLADROVCI: Faleminderit, kryetar! Fjalën ia kaloj zëvendësministrit të financave.

NAIM FETAHU: I nderuari kryetar i Komisionit,
Të nderuar anëtarë, deputetë,

Të nderuar të pranishëm dhe media,

Ministria e Financave ka filluar hartimin e Projektligjit për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditorit të Republikës së Kosovës gjatë vitit 2012. Pasi Kuvendi i Republikës së Kosovës kishte propozuar plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit ekzistues i cili rregullon funksionimin e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm.

Me qëllim të përfshirjes të rekomandimeve të Kuvendit të Republikës së Kosovës, por edhe duke parë të nevojshme hartimin e një ligji gjithëpërfshirës, të detajuar i cili rregullon në tërësi funksionimin e Auditorit të Përgjithshëm dhe Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm, Ministria për Financa, ka hartuar një projektligj tërësisht të ri i cili plotëson të gjitha këto kritere.

Ky projektligj përcakton akterët të këtij projektligji, fushëveprimin për auditimin e jashtëm të fondeve publike, ekzekutimin e buxhetit si dhe përdorimin dhe qeverisjen e burimeve publike.

Po ashtu ky ligj rregullon organizimin e veprimtarisë dhe kompetencat e Auditorit të Përgjithshëm dhe Zyrës Kombëtare të Auditimit. Në këtë kontest, përmes këtij ligji auditorit të përgjithshëm dhe Zyrës Kombëtare të auditimit të sigurohet një pavarësi e lartë ashtu siç e parasheh edhe Kushtetuta e Republikës së Kosovës dhe standardet ndërkombëtare të kësaj fushe.

Njashtu projektligji ka rregulluar edhe mënyrën e bashkëpunimit të të gjitha institucioneve publike me auditorin e përgjithshëm dhe ofrimin e informatave në procesin e auditimeve. Konsiderojmë se Projektligji do të evitojë edhe paqartësitë ekzistuese sa i përket fushave të auditimit, formës dhe përmbajtjes së tyre të cilat janë përshkruar në mënyrë detale në këtë projektligj.

Vlen të theksohet që ky projektligj është vlerësuar edhe nga Komisioni Evropian dhe akterë të tjerë të përfshirë në procesin e hartimit të tij. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zyra e juaj a ka komente për Ligjin, nëse ka urdhëroni.

NAIM FETAHU -Projektligjin edhe nëse ka komente specifike në grupet punuese, më vonë ne do të marrim pjesë dhe do t'i trajtojmë së bashku. Tash për tash nuk kemi ndonjë koment si Ministri e Financave tjetër po mendoj me projektligj.

KRYESUESI: Faleminderit! Para se t'ia jap fjalën zotit Olofsson, dua ta përshëndes përfaqësuesin e Zyrës së Komisionit Evropian i cili është në cilësinë e vëzhguesit këtu. Zoti Llage, e keni fjalën.

LAGE OLOFSSON (Nga përkthyesja simultane): Faleminderit shumë Ramiz! Ministria e Financave e cila ka qenë përgjegjëse për hartimin e këtij draftligji, ka punuar shumë mirë me këtë ligj mendoj dhe është një hap përpara shumë i mirë dhe interesant sipas mendimit tim dhe pasi kjo është prezantuar dhe është diskutuar në leximin e parë në Parlament, janë bërë disa komente nga deputetë të ndryshëm dhe të cilat janë studiuar edhe nga SIGMA dhe gjithashtu neve kemi marrë edhe disa komente nga Sindikata e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm. Unë mendoj që këto i kristalizojnë disa çështje të cilat janë shumë të rëndësishme për ne që t'i adresojmë para se ta kemi këtë ligj në fuqi.

Nëse ne i shikojmë komentet që i kemi marrë nga shoqëria ndërkombëtare, pra le të themi, ata kanë shumë të bëjnë me çështjen rreth pavarësisë së auditorit të përgjithshëm dhe nëse dikush këtu është i interesuar, mbi tavolinë i keni versionet në shqip dhe në serbisht të deklaratës së Limës, deklaratës së Meksikës dhe Rezolutën e Kombeve të Bashkuara plus edhe një letër të cilën e kam shkruajtur unë vet, e cila tregon se sa e rëndësishme është për demokracinë që të kemi një auditor të përgjithshëm të pavarur.

Këto janë parimet që çdo vend në botë për të cilat çdo vend në botë punon dhe mendoj se është shumë e rëndësishme për Kosovën dhe qytetarët e Kosovës që ne të punojmë në të njëjtin drejtim ashtu sa më shumë që të jetë e mundur. Pra, sipas mendimit tim ne i kemi disa sfida këtu dhe ato kryesisht janë të lidhura jo me mandatin e auditorit të përgjithshëm apo të zyrës, ato nuk kanë të bëjnë me atë se çka do të auditohet apo jo sepse aty nuk shohim ndonjë koment, pra të gjitha lidhen me atë se çka do të thotë, pra se pavarësia e Auditorit të përgjithshëm, si do ta sigurojmë që Auditori, se çka do të bëjmë se Auditori i përgjithshëm të mos jetë një lloj pashaje apo një lloj mbreti në institucion, pra a kemi ndonjë mekanizëm që të themi e të sigurojmë që ai do të mbahet përgjegjës, që do të kemi drejtpeshime rreth asaj çka ai është duke bërë apo duke mos bërë si dhe lirinë apo pavarësinë që ky funksion duhet të ketë në mënyrë që të funksionoj si duhet.

Pra pyetjet që dalin këtu është sigurisht, a duhet Zyra e Auditorit të Përgjithshëm dhe auditorëve të tjerë a duhet të jenë një shërbyes civil, do të jenë anëtarë të Shërbimit Civil apo jo, çfarë do të thotë kjo? Në mendimin tim dhe kjo gjithashtu është vërejtur edhe nga eksperti i SIGMA-s e tjerë.

Regjimi aktual i shërbimit civil në Kosovë, idetë që i kanë ata për zhvillimin e Shërbimit Civil, si për ligjin primar dhe atë sekondar edhe për Ligjin për pagat në Shërbimin civil dhe Shërbimin civil, kjo strukturë nuk përshtatet për nevojat e një zyre të pavarur të auditimit të përgjithshëm.

Ne duhet në një mënyrë të mendojmë se si duhet ta adresojmë këtë dhe të sigurojmë që Auditori i Përgjithshëm të ketë pavarësinë për të vendosur për disa gjëra, a të vendos vet për disa gjëra.

Në këtë draftligj, thuhet se vetë Auditori i Përgjithshëm përmes legjislacionet sekondar do të vendos vetë por sigurisht përmendet që duhet të ketë lidhje me vlerat e legjislacionit të Shërbimit Civil dhe me standardet ndërkombëtare. Dhe gjithashtu, në këtë draft thuhet që okej, këtu jepet siguri e mjaftueshme që ai do të bëjë për shembull çka do që do të dëshirojë.

Pyetja e dytë që nuk ka të bëjë me Shërbimin civil, por ka të bëjë me llojet e kompetencave apo fuqisë së Auditorit të Përgjithshëm për sa i përket emërimit të menaxhmentit të lartë të tij.

Pyetja fillimisht është: kush do ta emëroj apo caktojë menaxhmentin nën Auditorin e Përgjithshëm, cilat do të jenë kriteret për ta bërë këtë në një mënyrë transparente dhe në një mënyrë të mirë. Në draftligj kjo është thënë shumë qartë dhe është një detyrë për Auditorin e Përgjithshëm. Këtu kanë ardhur shumë komente, për shembull: Kuvendi duhet ta bëjë apo që duhet të vendosen më shumë kriteret në draftligjin për sa i përket mënyrës se si këta njerëz duhet të emërohen apo caktohen.

Në të dy rastet mendoj që këto lloj kriteret strikte për t'i vendosur në ligj, për mendimin tim e bënë procesin shumë të ndërlikuar për t'u ndryshuar dhe për të punuar në të ardhmen sepse me kalimin e kohës gjërat ndryshojnë.

Pjesa tjetër....

Mirëpo, çështja tjetër që lidhet me këtë, ka të bëjë me vetë emërimin e auditorit të përgjithshëm. Sa mund të rregullohet mënyra për këtë se si, presidenti pra, do të punojë për sa i përket propozimit në Kuvend për auditorin e përgjithshëm potencial, pra sa mund të rregullohet përmes këtij ligji.

Pra, është pak e vështirë për mua të kuptoj, sepse në një ligj të tillë këtu nuk duhet të rregullohet mënyra se si duhet të punojë presidenti, mendoj se kjo është një gjë

më e përgjithshme. Pra, këto janë tre gjëra, që janë shumë të rëndësishme për ne, për të gjetur një zgjidhje. Ne e kemi gjithashtu edhe disa komente të vogla dhe disa komente, që mund të dalin gjatë trajtimit në të ardhmen të draftligjit. Kjo është nga unë për momentin. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Komisioni do t'i ketë parasysh vërejtjet dhe komentet tuaja. Para se t'ia jap fjalën përfaqësuesve të sindikatës, ndoshta edhe zëvendësi... Zoti Artan a ke diçka? Fjalën e keni ju.

ENVER BOQOLLI: I nderuar zoti kryetar i komisionit,

Të nderuar deputetë,

I nderuari zoti zëvendësministër,

I nderuari auditor dhe stafi i tij,

Të nderuar përfaqësues të OSBE-së,

Të tjerë të pranishëm,

Unë ju falënderoj që më keni dhënë rastin të shpreh edhe unë në emër të Sindikatës së Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm të Kosovës disa komente rreth këtij projektligji.

Ne e kemi përcjell këtë hartim të projektligjit që nga fillimi dhe kemi pas debate të brendshme dhe i kemi trajtuar shumicën e tyre brenda, por ne ende mendojmë se ka disa çështje që mendojmë se duhet të plotësohen, të jetë një draft edhe më i mirë para se të jetë ligj final.

Ne komentet i kemi dorëzuar para dy ditësh në formë të shkruar edhe komisionit, por unë po mundohem shkurtimisht, pasi që veç kryesuesi e përmendi që i kemi nga 5 minuta për kohë, nuk do t'i lexoj të gjitha, por do të përpiqem që t'i përmbledh sa më shkurt edhe ato që janë sa më të rëndësishme.

Unë po mendoj të neni 3, pika 5.1, ku thotë “përvoja e duhur për t'u zgjedhë një auditor i përgjithshëm...”, kërkohet të jetë vetëm 5 vjet, pa pasur asnjë përvojë madje as menaxhuese. Duhet të shtohet aty dhe të bëhet 10 vjet e jo 5 vjet, që për neve duket që janë pakë 8 vjet dhe jo vetëm 8 vjet e një përvojë e thjeshtë e pa asnjë përvojë në menaxhim, se rëndësia e përvojës menaxhuese për të parin e institucionit tonë, që është kaq i rëndësishëm dhe aq i ndjeshëm, unë mendoj që është domosdoshmërisht e nevojshme dhe kërkoj që kjo aty të vendoset.

Te neni 4, ku thuhet se përmes këtij ligji themelohet zyra kombëtare e auditimit, unë mendoj se zyra, faktikisht me të njëjtat role, misione dhe detyra, veç funksionon që prej 2003-ës e themeluar qysh me rregullore të UNMIK-ut në 2002-

ën dhe nuk kemi nevojë të themelojmë diçka që në fakt ekziston, ndoshta kemi nevojë me ia ndërrua emrin, por s'kemi nevojë të themelojmë diçka të re, edhe pse i shtohen ose i modifikohen disa kompetenca, nuk ka nevojë me u krijuar diçka rishtas prej fillimit.

Te struktura, kemi edhe atje një dilemë, që ndoshta është çështje për debat edhe më të gjerë dhe do ta trajtoni edhe ju në debatet tuaja të mëvonshme. Ne jemi institucion monokratik dhe në këtë mënyrë qysh është dizajnuar që të ndahet përgjegjësia në mes të auditorit të përgjithshme dhe në mes sekretarit të përgjithshëm, që mund të jetë si zyrtar kryesor administrativ, në rastin tonë auditori i përgjithshëm është zyrtari kryesor administrativ dhe nuk është nevoja të bëhet një përshkallëzim ose një dyfishim i pozitive me kompetencë afërsisht të njëjta, se nuk aty ndonjë dallim se cilat kompetenca dallojnë njëri prej tjetrit.

Janë përmendur edhe disa pozita atje, të cilat nuk përmenden se si zgjedhën, çfarë kriteresh duhen për t'u zgjedhur, sikur pozita e asistentëve dhe pozita e zëvendësauditorit, që mbetet në vullnetin dhe mënyrën e papërcaktuar, të papërkufizuar me ligj, por i mbetet hapësirë që auditori i përgjithshëm t'i caktojë me rregullore të brendshme. Dhe, ato rregullore të brendshme dihet mirëfilli, se mund të ndërrohen në çdo kohë dhe në çdo moment, që nënkupton se mund t'i përshtaten ndonjë individ, në kohë të caktuar për ndonjë individ të caktuar.

Pra, pozitat që janë ligjore, unë mendoj se duhet të jenë edhe minimum i kriterëve ligjore, se si zgjedhën, si shkarkohen, sa zgjatë mandati i tyre dhe a përtërihet ajo mandati i tyre, duke përfshirë për zëvendësin, asistentët ose edhe sekretarin, e jo vetëm të mbesin pozita të krijuara me ligj, pa ditur se cila është detyra e tyre, si zgjedhën, si emërohen, si shkarkohen, sa mandate dhe a zgjedhën a nuk zgjedhën edhe për një mandat të dytë.

Gjithashtu te neni 9.3, mendoj se kur i ka përmendur përqindjet e pagave, krahasuar me auditorin e përgjithshëm të asistentit dhe të zëvendësit e të sekretarit, unë mendoj se edhe këto përqindje duhet të korrigjohen pak, se kur thotë zëvendësi i tij merr 70% të pagës së tij, unë mendoj se duhet të jetë 80 – 95 e kanë të tjerët zëvendës, duke përfshirë zëvendësministrin për ministrin ose zëvendëskryeministri për kryeministrin, ose analogjia e përfaqësuesit të institucioneve të tjera, që zëvendësi me të parin sillen mbi 80, deri në 95 e jo 70, se kjo reflekton në ulje të pagave për secilin më poshtë, kur nivelet më poshtë mbesin më poshtë, sigurisht që stafi do të mbetet atje... me paga shumë më të ulëta, se nuk mund stafi i mesëm të ketë pagë mbi stafin menaxhues. Edhe ajo është shumë e rëndësishme, se duhet të sigurohet pavarësia edhe e institucionit, por edhe e zyrtarëve të tjerë, duke

përfshirë aty edhe mënyrën e pagesave. Se, nëse stafi profesional paguhet mirë do të vazhdojë të mbesë profesional dhe të mbetet në zyrë. Ne kemi pasur lëvizje të shumta dhe edhe më tutje kemi lëvizje që ikin stafi profesional me përvoja prej zyrës dhe shkojnë atje ku gjejnë paga më të mira.

Domethënë, nevoja është që të ketë pavarësi institucionale, paga më të mira për menaxhmentin që të jetë një menaxhment më mirë, por gjithsesi edhe për stafin profesional të nivelit të mesëm atje, që ata janë ajo makineria, motori i institucionit, që gjithë ditën janë në terren duke kryer punën, për çka edhe është i themeluar institucioni.

Të qenët ose të mos qenët shërbyes civil, edhe kjo është temë e gjerë dhe dilema mund të ketë edhe kundërthënie mund të ketë, por nuk na siguron pavarësi të stafit të mesëm atje, nëse mbesim në mëshirën e vullnetit dhe rregullave të brendshme të një auditori të brendshëm, një auditori të përgjithshëm aty, stafi i brendshëm, se ato mund të ndryshojnë çdo kohë prapëseprapë dhe aty mund të ulet ajo pavarësia e auditorëve nga një presion i mundshëm i një auditori, nuk po dua tash të them i këtij ose i dikujt tjetër, por kurdoherë në afate të gjata e jo në afate qoftë aktuale, ose diçka afatshkurta. Dhe, ideja është që të ketë kriterë të mundshme dhe siguri të arsyeshme për secilin nivel, qoftë edhe në nivelin menaxhues por edhe stafin e mesëm dhe stafin profesional, se kështu siç është projektuar ky ligj, te neni 9 dhe 10, atje faktikisht stafi nuk ka ndonjë adresë të ankesës, sikur qysh ka qenë rasti me shërbyesit civilë të Këshillit të pavarur mbikëqyrës i shërbyesve civilë. Në këtë rast mund të themelohet një organ i brendshëm, që mund të jetë ose të mos jetë i pavarur në vendime, por atë drejtë tjetër, përveç te gjykata s'ka. Por, nëse shkojmë te gjykata me këtë projektligj aktual qysh është, çfarëdo që të ndërmarrë një auditor i përgjithshëm, ndaj cilitdo staf profesional atje, mund të thotë “shoki, brenda ligjit është, e ka zbatuar ligjin, edhe ditën e mirë...”.

E këtu është arsyeja me ikë prej subjektivizmave të mundshme dhe me kalua në objektivitet. Të ketë objektivitet në ligj, të ketë siguri edhe për stafin, në këtë mënyrë ashtu të krijohet ajo përshtypja, qysh e tha edhe vet auditori i përgjithshëm zoti Lage, që të mos krijohet një pasha, a pashallëk apo ku e di unë si po e komentojnë andej – këndeje.

Kemi edhe te neni 23.3, atje ku thotë se data 15 shtator është e përcaktuar për të raportuar në Kuvend për raportin vjetor. Këtu krijohet një lloj kolizioni ligjor, kur me ligjin e menaxhimit të financave, nenin 48.4 thotë është data 31 gusht, ndërsa këtu thotë është 15 shtator. Këtu krijohet një kolizion. Unë mendoj se këto dyja

duhet të harmonizohen, të mbahet ose e njëjta datë, ose nëse duhet të jetë kjo datë, të thuhet se kjo mbizotëron në raport me atë nen atje të atij ligji.

Edhe te neni 12.2 është caktuar atje, thotë mund të angazhojë “SAI, e tjerë për të kryer punë”. Unë mendoj se aty duhet të përmendet një kufizim i asaj, se sa mund të angazhojë auditori i përgjithshëm punë nga një SAI i jashtëm, deri në çfarë shkalle, deri në çfarë mase, jo me mbet e pa përkufizuar, në kurrfarë mase, mund ta kufizoj të them 90% a 50%, ajo duhet të jetë e papranueshme, duhet të jetë një minimum i caktuar, derë në këtë shkallë a masë, e jo të mbesin gjërat të pa matshme, të pa përkufizuara, se kjo nuk na bën mirë, na bën vështirësi në zbatim të ligjit dhe duhet t’i tejkalojmë këto gjëra.

Unë ju falënderoj që më dhatë rastin, dhe njëherë për njëherë s’kam më shumë të flas.

KRYESUESI: Faleminderit Enver! Vërejtjet dhe komentet e juaja i kemi marrë edhe me shkrim. Sigurisht, se komisioni do t’i ketë parasysh.

Sa i përket nenit 9, paragrafit 3, ne si komision do ta kërkojmë mendimin edhe nga Komisioni për Buxhet e Financa, kur është fjala për pagat.

Diskutimi është i hapur edhe për të tjerët, kështu që unë i ftoj, kush dëshiron të kontribuojë, mund ta marrë fjalën. Urdhëroni!

SHQIPE ARIFAJ: Faleminderit! Përshëndetje për të gjithë!

Unë jam përfaqësuesja e Asociacionit të Komunave të Kosovës. Së pari ju falënderojmë për ftesën që na keni bërë.

Ne si Asociacion i Komunave të Kosovës kemi takime të rregullta me auditorë të komunave dhe me... njëri prej shqetësimeve tona që ka qenë e që shpresojmë se ky ligj do ta rregullojë, besojmë se ky ligj do ta plotësojë numrin do të rregullojë burimet njerëzore, sepse auditori i përgjithshëm deri tash nuk ka pasur kapacitete vetë me e bërë auditimin nëpër disa komuna, e ka bërë përmes kompanive private.

Auditimi i përgjithshëm prej auditorit të përgjithshëm dhe auditimi prej kompanive private, kurrë nuk kanë në përputhje.

xxx

Domethënë shpesh ka pas diskrepancë shumë të madhe. Nëse auditimi është bë prej auditorit gjeneral ka qenë ndryshe, nëse është bë prej kompanisë private

shumë ka pas ndryshime të mëdha domethënë që komunat gjithmonë janë ankuar që kompanitë private nuk po janë shumë real, se më shumë po e shohin atë se me qenë sa më kritik je kompani më e mirë.

Kështu që ne besojmë që tash do të kompletohen burimet, do të ketë burime të mjaftueshme që auditimin ta bëjnë vetë jo përmes kompanive tjera. Po ashtu, nëse pavarësia na e kuptojmë se Institucioni i Auditimit është i pavarur mirëpo nëse nuk janë shërbyes civil këta duhet të kategorizohen a janë agjension i pavarur, a janë zyrtarë administratës shtetërore apo çka janë.

Dhe, shqetësimi tjetër ka qenë që për shembull në disa komuna auditori i brendshëm e ka pas pagën më të madhe se kryetari i komunës, kështu që na e kuptojmë që duhet me qenë të pavarur, mirëpo jo me e kalu pagën e një kryetari të komunës i cili është i zgjedhur me vota të popullit. Kështu që këto kanë qenë, ne do të meqenëse komunat ende nuk janë konstituuar drejtoritë komunale ne do ta diskutojmë këtë projektligj edhe me grupet punuese me komunat dhe grupet punuese të komisionit parlamentar do t'i përcjellin rekomandimet me shkrim. Faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zonjë! Mendoj që do të na i dërgoni këto vërejtje, komentet e juaja edhe me shkrim. Sa i përket pagës së auditorit të brendshëm është e rregulluar me ligj për auditorin e brendshëm edhe ajo mund të rregullohet.

Sa i përket auditimeve nga kompanitë e jashtme janë të kontraktuara prej Zyrës së auditorit dhe auditori mban përgjegjësi, ato nënshkruhen më në fund edhe prej auditorit, kështu që edhe na si komision kemi kërkuar gjithmonë me i auditu krejt komunat, zyra e auditorit, por për shkak të mungesës së stafit ajo u detyru me kontraktu edhe organizata të jashtme. Urdhëro, Valbonë!

VALBONA DIBRA: Ju faleminderit, zoti Lladrovci!

Do të lidhna pak me shqetësimin e zonjës, ne kur e kemi diskutuar edhe në grupin punues para dy dite projektligjin, një prej shqetësimeve ka qenë edhe neni 12, paragrafi 2. dhe unë në këtë rast edhe vazhdimisht ka qenë edhe shqetësim i komisionit edhe zoti Lage është i informuar që ne i kemi kërkuar vazhdimisht që numri i komunave të cilat i jepet për auditimit që i jepet një kontraktori të zvogëlohet fatmirësisht, ky numër i komunave nga viti në vit është zvogëluar dhe është shenjë e mirë, mirëpo ndoshta do të ishte më e mirë ose do të duhej të merret edhe nga ne edhe nga akterët tjerë më seriozisht që Zyra e Auditorit gjeneral të ketë stafin i cili do të merret me auditimin e komunave.

Unë mendoj që qitash diku janë mos gabofsha 140 auditor, mundët me më përmirësua auditori ose stafi krejt, 120 kështu që ndoshta do të ishte më pak e kushtueshme investimi në staf, në auditor se sa të bëhet kontraktimi i komunave i cili kushton më shumë dhe tash i kemi në ligj edhe më poshtë këto paragrafin 3, që nëse ose diku në një paragraf tjetër që thotë që nuk duhet të ketë lidhje tjera ose punë i angazhuar kompania me ndonjë kompani private.

Ne e dimë që i kemi 2-3 kompani këtu të licencuara të auditimit, kemi më shumë por zakonisht 2 a 3 janë më efektive që punojnë. Dhe si do të menaxhohet ky problem, unë mendoj që ndoshta do të ishte e arsyeshme që ky nen krejt të hiqet dhe të përforcohet zyra e auditorit të përgjithshëm me staf, me auditor dhe paragrafi 2 i nenit 12 po i njëjti paragraf do të kisha dashur ta pyes ose auditorin ose sponzorizuesin, Qeverinë çka kanë menduar të angazhojë çfarëdo personi, firmë të kualifikuar apo ndonjë institucion tjetër - brenda auditimit për t'i ndihmuar. Çka do të thotë a do të thotë kjo që Zyra e Auditorit ka të drejtë të angazhojë ndonjë këshilltar apo mund të na e jepni sqarimin.

Mirëpo, ne si komision dhe si grup punues ndoshta do të ishte mirë seriozisht ta mendojmë, normalisht që do të duhej të merret edhe komenti i auditorit të përgjithshëm që Zyra e Auditorit është më e arsyeshme të marr staf dhe të kryejë auditimit e komunave se sa të merr të kontraktin kompani, sepse edhe auditori gjeneral ka thënë disa herë që nuk është shumë efikas, në vazhdimësi kanë qenë edhe më herët tash nuk e di, kanë qenë auditorët e zyrës së auditorit të cilët kanë qenë vazhdimisht bashkë me kompaninë me auditorët e kompanisë të cilët janë kontraktuar, tash nuk e di a janë përcjellës apo ju kanë lënë në duar krejt kompanive private auditimi i komunave.

Është një problem serioz që mendoj që duhet ta trajtojmë më gjerësisht. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, Valbonë!

Është jo profesionale me ia ndalu auditorit me marr veprime të kontraktume nga auditorët e jashtëm, por sido që të jetë na do të diskutojmë edhe do ta bëjmë këtë projektligj që të jetë një ligj sa më i mirë në harmoni me standardet e INTE-sait.

Zoti Lage nëse ki koment të shkurtë, por na sot jemi tu punu në projektligj jo në debate e diskutime, por nëse ki diçka, e ki fjalën.

LAGE OLOFSSON (Nga përkthyesja simultane): Meqë u ngrit kjo çështje e auditimit të komunave nga dy anë do të thoja, dua të bëj një koment të shkurtë.

Siç e tha edhe kryetari kjo është një parim fillimisht, duhet t'i takojë auditorët e përgjithshëm të vendos se cilat burime ai apo ajo do të përdorë për të kryer detyrën e tij apo të saj. Është gjithkund nuk e di pse kosovarët duhet të jenë kaq specifik, duhet të përdoren pra standarde ndërkombëtare dhe së dyti kjo ka të bëjë, e dyta kishte të bëjë me faktin a do të ishte më efektive të përdoren burimet e brendshme për të arritur një detyrë, sigurisht kjo është një vendim menaxherial dhe s'e kuptoj idenë pse duhet të rregullohet këtu në ligj, kjo është një gjë tipike do të thoja ku ne kemi sfida në Kosovë dhe pikërisht kjo është ajo që duhen që disa çështje nga ligji primar të kalojnë në ligjin sekondar.

Pra, i takon çdo menaxheri në çdo organizatë të vendos nëse dikush duhet të ketë njohuri specifike, për një detyrë specifike për shembull për IT, specialist teknik apo ku ta di unë për të cilën nuk ke punë në të gjithë kohën. Pra, ju i angazhoni për një projekt të vogël, atëherë s'besoj që është një çështje për tu rregulluar në ligj. Kjo është e mundur, pra për tu bërë.

Unë e kam pasur politikën dhe gjithmonë e kam që Zyra e Auditorit të Përgjithshëm gjithmonë duhet të kontraktojë ndonjë punë në mënyrë që të bëjmë krahasime me kolegët tanë nga ana e sektorit privat. Kjo është shumë e mirë për sa i përket cilësisë tonë. Ne i kemi reduktuar nga 31 në 20, ne kemi reduktuar në 11 dhe në sezonin tjetër e kemi reduktuar në 6 komuna dhe nuk e kemi qëllim që ta reduktojmë aspak ata, punojnë në emrin tim dhe ata i qëndrojnë cilësisë dhe standardeve tona që i kërkojmë ne.

Më përpara i kemi pasur disa probleme, të cilat tashmë nuk ekzistojnë është shumë e qartë. Ne i kemi takuar të gjithë kryetarët e komunave të premtën dhe kemi diskutuar me ta dhe nuk mendoj që kjo është diçka që duhet të trajtohet në ligj, faktikisht aspak.

Në vend të kësaj, pra ne duhet të shkojmë drejt këtyre kriterëve të pavarësisë të cilat janë të paraqitura në standardet ndërkombëtare.

KRYESUESI: Pavarësinë e plotë në punën e juaj do ta ketë edhe më tutje Zyra Kombëtare e Auditimit të Kosovës të njëjtën pavarësi ose edhe veç më të mirë.

Përfaqësuesi i Ministrisë së Financave e ka fjalën.

QERKIN BERISHA: I nderuari kryetar!
Të nderuar të pranishëm,

Shkurtimisht ndoshta me i adresuar disa prej komenteve që veç u dhanë këtu, duke qenë se vetë kam qenë pjesë e Komisionit Qeveritar së bashku edhe me Lagen edhe me përfaqësues tjerë të Qeverisë në hartimin e këtij projektligji.

Ajo çka kemi bërë ka qenë që jemi munduar që auditorit të përgjithshëm edhe Zyrës Kombëtare të Auditimit që tash e kemi quajtur kështu t'i japim një pavarësi të tillë të cilën ia njeh edhe Kushtetuta e Republikës së Kosovës. Nuk i kemi dhënë as më pak as më shumë, domethënë.

Kushtetuta, auditorin e përgjithshëm e njeh si një institucion me pavarësi të plotë dhe flet për auditorin e përgjithshëm, prandaj këto komente se apo krijojnë njëfarë institucioni që ka pavarësi shumë të madhe ndoshta aty duhet të gjenden te këto dispozita të Kushtetutës për shkak se auditori është ai që vendos për stafin e vet edhe komplet çështjet e auditimit duke pas parasysh procedurat dhe rregullat që ne i përcaktojmë me këtë ligj por që kanë qenë të përcaktuara edhe me ligjin paraprak.

U shtriu çështja e nenit 4, themelimit. Ne në fakt, duke pasur parasysh që këto kemi bërë si një ligj të ri dhe kemi shku në shfuqizimin e ligjit paraprak normalisht që kemi lënë themelimi, por sidoqoftë ky nen ka mundësi me u plotësuar edhe me u ndryshuar edhe me thënë që zyra e auditorit të përgjithshëm e themeluar me ligjin paraprak ose me Rregulloren e UNMIK-ut ose sido që doni ta amandamentojmë shndërrohet në Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës, kjo nuk paraqet ndonjë far problemi.

Kështu që ka mundësi me u amendamentu edhe nuk kish dashur të konsiderohet si problem.

Çështja e Sekretarit të Përgjithshëm që u trajtua këtu, mendoj që mundet me u zgjidh, ndoshta mundet me qenë edhe drejtor i përgjithshëm ose drejtor i përgjithshëm në fakt. Kjo kur është fut në ligj janë analizuar edhe institucione tjera keni parasysh edhe Gjykatën Kushtetuese, keni parasysh edhe institucionet tjera të pavarura të tek ne në Kosovë është praktikë të ketë një sekretar të përgjithshëm, kjo nuk nënkupton se ato do të kenë përzierje të kompetencave.

Çështja e sekretarit të përgjithshëm kish me qenë komplet administrative dhe jo e ndërlidhur me fushën e auditimeve që auditori i përgjithshëm, po pra me administratën, kanë drejtorë të administratës kish mujt me qenë sekretar i përgjithshëm kjo është ajo çka është menduar.

Kriteret e përzgjedhjes së zëvendës auditorëve edhe stafit tjerë në pozita të larta menaxhuese unë mendoj që ka mundësi me u fut në ligj edhe pse Kushtetuta nuk

flet për staf tjetër, flet për auditorin e përgjithshëm dhe duhet pasur parasysh që edhe këtij institucioni nëse flet për auditorin e përgjithshëm Kushtetuta duhet me ia lënë kompetencat me vendos vetë për stafin e vetë, po flas për këto pozitat që janë menaxhuese, zëvendës auditorët, asistentë auditorët dhe stafin tjetër. Sidoqoftë, në ligj ka mundësi me u fut kritere mbi bazën e të cilave duhen ose mund të zgjidhen këto pozita.

Sa i përket pagave ne s'kemi pas të rregulluar këtë çështje dhe kemi vendos një sistem të tillë, sidoqoftë mbetet tek Kuvendi prapë dhe te komisioni jua me rregullu nëse konsideroni që nuk është në rregull.

Sa i përket çështjes së shërbimit civil këta edhe pse kemi thënë që tash e tutje nuk do të jenë shërbyes civil, sepse deri tani jemi kritikues i Qeverisë se po ndërhyjmë në pavarësinë e auditorit të përgjithshëm tu pas parasysh që ne përmes Ministrisë së Administratës Publike i caktojmë rregullat dhe bëjmë komplet procedurat e emërimit të këtyre stafit po mendoj, stafit të shërbimit civil. Kemi menduar që me ndryshu dhe që këta tash të jenë tash e tutje shërbyes publik, normalisht auditori i përgjithshëm i përcakton rregullat me akt nënligjor.

U tha këtu që ato mund të ndryshohen, por nëse rregullat e tilla, aktet e tilla nënligjore janë të hartuar dhe të miratuar dhe mbi bazën e të cilave konkurrojnë edhe zgjidhen stafi nuk besoj që kjo do të ishte problem që t'i lihet auditorit të përgjithshëm. Na po flasim këtu për një institucion që ka me i auditu edhe të tjerët, krejt institucionet publike dhe nuk po mendojmë që një institucion i tillë kish me kriju probleme për vetë stafin e vetë. Kështu që qëllimi ka qenë i mirë edhe ka shku në kuptimin e pavarësisë së auditorit të përgjithshëm.

Angazhimi i stafit të jashtëm, ky nen që u përmend edhe u theksu e len mundësinë e angazhimit të stafit të jashtëm që edhe deputetja e përmendi ku thuhet “të kontraktojë individë ose kompani”, kur thuhet “të kontraktojë individë” nënkupton që mundet me zgjedh njerëz përmes një konkursi normalisht me kontrata afat shkurtër, kjo nënkupton që për një auditim nëse ka nevojë me e bë një auditim ta zëmë të një komune nuk ka nevojë tash një staf atje të qëndrojë me kontratë të përhershme, por kryhet ai auditim...tash këto janë komentet në lidhje me atë çka e tha ka mundësi me u kry auditimi edhe prej një personi varësisht prej institucionit që auditohet, por ka mundësi të angazhohen edhe kompani.

Edhe kur angazhohen kompani aty munden me qenë 1, 2, 3 ose më shumë persona por mundet me u angazhu edhe një individ me kontratë afat shkurtër për me i kry

ato auditime. Ai individ normalisht që duhet t'i plotësojë kriteret profesionale për me e kry një auditim të tillë.

Nuk ka mundësi financiare me e angazhu një numër të madh të stafit, i cili kish me qenë permanent në zyrën e auditorit të përgjithshëm për atë ju ka lënë mundësi auditorit të përgjithshëm me kontrakt kur ka nevojë me kry auditime të tilla.

Këto ishin komentet tona nga ana e Ministrisë së Financave. Faleminderit, shumë!

Vazhdon

KRYESUESI: Faleminderit! Sa i përket nenit 4 te themelimi, ajo ka me kanë një vazhdimësi.

Valbonë, nëse më lejohet!

Sa i përket stafit civil kishte me kanë më mirë se krijon profesionalizëm, vazhdimësi e kështu me radhë por ne do t'i marrim metodat më të mira, do ta diskutojmë, do t'i shtjellojmë këto probleme dhe do të vendosim si komision me ia propozuar Kuvendit, Kuvendi do të vendosë për të gjitha këto.

A ka ndokush tjetër për të diskutuar? Nëse ka dikush tjetër për të kontribuar akoma, ne jemi të hapur ta dëgjojmë dhe ju jeni të hapur me i marrë edhe vërejtjet, sugjerimet. Nëse nuk ka dikush tjetër, me shtue diçka, atëherë e përmbyllim. Po, urdhëro!

(Ndërhyrje)

Për këtë keni ju probleme shumë sepse harroni. Unë në fillim ju tregova që i keni 5 minuta, kështu që dy herë nuk mund të flisni, por megjithatë po ua jap fjalën edhe një herë.

ENVER BOQOLLI: Se është atje te neni 17... ku përmendet që nuk mund të punojnë asnjë punë që krijon të ardhura. Unë e kam përmendur edhe në koment atje, që stafi mund të punojë edhe punë tjera që krijon të ardhura por me kusht që të mos jenë konflikt i interesit dhe mos të jenë punë të njëjta ose të ngjashme, sepse punë që krijon të ardhura mund të jenë edhe ato në bujqësi, në blegtori dhe i kam përmendur edhe atje, ne kemi artistë, këngëtarë e çkamos, ata që dalin, shkojnë e këndojnë atje të dielave – dasmave e çka di unë, ata krijojnë të ardhura. Çfarë konflikti krijon ajo e ardhme, që u ka pamundësuar këtu me këtë ligj ose në fakt

është mbet e mundshme me bë kërkesë të tillë dhe nëse don me ta aprovuar ose jo auditori i përgjithshëm.

Po s'është nevoja me hy në ato telashe atje, se tani aty krijohet mundësia dikush dikujt po për njëjtën çështje, dikush dikujt jo për të njëjtën çështje dhe unë mendoj se edhe ai nen atje duhet të rregullohet. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Urdhëro Valbona!

VALBONA DIBRA: Ndoshta kishe me qenë mirë, se e kam pas edhe në mendje këtë pyetje. Është mirë që Zyra e auditorit me krijuar të hyra. Shumë është në rregull dhe me bë auditive, mirëpo mua nuk më kujtohet që e kam pa në pasqyra financiare të hyrat qysh janë kategorizuar dhe për çka e keni planifikuar me i shpenzuar ato të hyra që i krijoni, a shkojnë në llogari të Zyrës së auditorit direkt apo shkojnë në llogari të thesarit.

Edhe një koment, zoti Lage, para se me u përgjigjur. Më fal! Dua me ia thënë përfaqësuesit të Qeverisë lidhur me nenin që e diskutoi më herët. Unë asnjëherë në përvojën time nuk kam ndie që bëhet auditimi prej një personi dhe lypa sqarim – person dhe kompani. Personi mund të angazhohet për qëllime tjera, siç e përmendi Lage dhe ndonjë ekspert, që unë vazhdimisht kam kërkuar ekspertë për çështje të ndryshme sepse auditorët nuk mund të jenë profesionistë për IT ose për çështje shëndetësore ose diçka të ngjashme, e auditimi prej një personi asnjëherë dhe në asnjë vend të botës nuk kryhet nga një person, se nuk është e lejuar.

KRYESUESI: Faleminderit Valbonë! Nuk jemi këtu me u shtye se çka ka me kanë, qysh ka me kanë, jena në dëgjim publik dhe ne do t'i marrim dhe dëgjojmë vërejtjet, sugjerimet e propozimet tuaja dhe ne si komision do të vendosim pikë për pikë, nen për nen, paragraf për paragraf për këtë projektligj se si do ta procedojmë në seancën e Parlamentit.

Sa i përket të hyrave, Valbonë, ne kemi diskutuar shumë herë. Të hyrat që i krijon Zyra e auditorit, i ka krijuar Zyra e auditorit, shkojnë në thesar, shkojnë në buxhet dhe buxheti dhe thesari ua kthen prapë dhe ata vendosin për çka me i shpenzuar ato.

A ka dikush tjetër për të diskutuar? Po, urdhëro Afrim!

AFRIM HOTI: Shkurt, unë desha vetëm për Lage, se është sindikata e pavarur e ZAP-it ka bërë shumë vërejtje lidhur me Projektligjin. Tash meqë është Lage këtu duhet ta sqarojë, kërkoj ta sqaroj, jo duhet ta sqarojë, por kërkoj ta sqaroj të na e sqaroj pak më në detale pse e ka kundërshtuar shumë sindikatën e pavarur.

Thotë, se unë i kam lexuar të dyat, thotë se s'janë profesionistë, po ky ligj do të bëhet që edhe punëtorët ose Lage, kur të mos jetë ky do të ekzistojë ligji, do të ekzistojë edhe në të ardhmen. Po kërkoj një sqarim direkt kështu nëse ka mundësi. Faleminderit shumë!

KRYESUESI: Afrim, më fal! Nuk jemi këtu për me i diskutuar problemet e sindikatës të pavarur të Zyrës së auditorit të përgjithshëm me Auditorin e përgjithshëm por jemi këtu për të diskutuar se si ta bëjmë një projektligj i cili ka me u bërë ligj në seancën e Parlamentit që është më mirë dhe i kontribuon më mirë vendit.

(Ndërhyrje)

Nuk jemi Afrim dhe nuk ia japi fjalën Lages për me e kthye përgjigjen, nuk jemi në atë temë. A ka ndokush tjetër sa i përket rendit që e kemi. Urdhëro, zoti Adem.

ADEM GRABOVCI: Faleminderit, nënkryetar! Përsëritet për të nderuarin Lage, për të gjithë të pranishmit.

Vetëm një fjalë do ta them. Ne kemi para veti një ligj për një institucion tepër të rëndësishëm, apo për mendimin tim ndër më të rëndësishmit dhe dëgjimet publike normalisht bëhen për t'i marrë mendimet e të gjithëve dhe kjo është shumë mirë që edhe si transparencë dhe na ndihmon që vërtet të hartojmë ligje sa më të mira dhe ne si deputetë kemi obligim t'i dëgjojmë po edhe të bëjmë seleksionimin.

Thelbi i këtij ligji dhe rëndësia e veçantë për mendimin tim që duhet të jetë, ne si deputetë nuk guxojmë të lejojmë që të cenohet pavarësia e auditorit të përgjithshëm. Duhet të shkohet nga ajo që të ruhet vërtet, të jetë i pavarur në vlerësimet e veta në punën e vet.

U dëgjua këtu edhe lidhur me angazhimin e stafit. Nuk mundemi ne, sepse për mendimin tim është e palejueshme që ne t'ia diktojmë se me kë do të bashkëpunojë Auditori i përgjithshëm. Ka nevoja të veta dhe duhet t'i ruhet një pavarësi e angazhimit të ekspertëve të fushave të ndryshme për çështje të caktuara, qoftë përkohësisht, qoftë për një rast, edhe për një rast të vetëm. Prandaj mendoj se ne këtu duhet të orientohe mi dhe ta ruajmë pavarësinë e plotë të auditorit të përgjithshëm dhe ta rregullojmë këtë me këtë ligj. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit Adem për këtë kontribut të jashtëzakonshëm! A ka ndokush tjetër diçka?

AFRIM HOTI: Edhe një herë kërkoj Ramiz, pse nuk mundet zoti Lage, pse të mos na i sqarojë shqetësimet që janë. Është e drejtë, ka të bëjë me projektligjin, nuk ka ndonjëfarë komenti.

KRYESUESI: Afrim, pyetja jote është me vend, është e mirë. Ne i kemi vërejtjet dhe kërkesat që i ka bë sindikata e pavarur, për atë edhe e kemi sot edhe përfaqësuesin e tyre, nuk kemi nevojë tash të jemi ne përfaqësues të sindikatës se është përfaqësuesi këtu dhe nuk kemi nevojë t'i diskutojmë ato probleme të cilat i kanë sepse i kemi edhe me shkrim, do t'i diskutojmë në takimet tona në pika të veçanta.

Atëherë, nëse nuk ka ndokush tjetër lidhur me projektligjin me shtua, unë ju kisha falënderuar për kontributin, për punën e mirë që është bë deri tash dhe ju përshëndes dhe me kaq po e përfundojmë këtë takim. Faleminderit

E përgatiti:

Njësia për transkriptim dhe lekturë